



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 108, datë 25.07.2025

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË
RREGULLOREN NR. 146, DATË 24.07.2019 “PËR ADMINISTRIMIN E
AKTIVEVE NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 8, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 146, datë 24.07.2019 “Për administrimin e aktiveve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve dhe Departamenti i Zbatueshmërisë dhe i Çështjeve Ligjore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**

➤ Në fund të nenit 1, shtohen fjalët “... si dhe llogaritja e provigjoneve për çështje gjyqësore, me qëllim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.”.

➤ Neni 3, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 8, e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligj nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rregullores nr. 109, datë 29.07.2020 “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e detyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, si dhe të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.”.

➤ Në fund të nenit 4, pas shkronjës “y”, shtohet shkronja “z”, me përmbajtje si më poshtë:

“Provigjon”, është një detyrim i pritur që rrjedh nga ngjarje të kaluara, i cili pritet të çojë në shpenzim të burimeve ekonomike për të shlyer atë detyrim dhe ku shuma ose koha e shlyerjes nuk janë të parashikueshme.”.

➤ Pas kreut IV, shtohet kreu V me përmbajtje si më poshtë:

“KREU V

LLOGARITJA E PROVIGJONEVE PËR ÇËSHTJE GJYQËSORE ME QËLLIM
EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË

Neni 28

Kriteret për Njohjen e Provigjoneve

Një provigjon për një çështje gjyqësore duhet të krijohet nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) Ekziston një detyrim aktual si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur;
- b) Kërkohet shlyerje e detyrimit;
- c) Shuma e detyrimit është e vlerësueshme.

Neni 29

Identifikimi dhe Vlerësimit i Çështjeve Gjyqësore

1. Njësia përgjegjëse për Çështjet Ligjore identifikon të gjitha proceset gjyqësore me palë Autoritetin dhe i pasqyron këto procese në regjistrin e çështjeve gjyqësore duke identifikuar statusin e tyre.

2. Klasifikimi i proceseve gjyqësore bëhet sipas natyrës së tyre.
3. Struktura që ndjek çështjet gjyqësore, në bashkëpunim me sektorin e financës, bën vlerësimin e probabilitetit të çështjeve për të cilat janë depozituar kërkesë paditë dhe për të cilat ende nuk ka një vendim gjyqësor.
4. Vlerësimi i mundësisë të humbjes për krijimin e provigjoneve do të llogaritet si më poshtë:
 - a) Deri në 50% (probabilitet i ulët) – Në këtë rast mundësia për humbje në procesin gjyqësor nga Autoriteti është më e ulët se 50%;
 - b) Mbi 50% (probabilitet i lartë) – Mundësia për humbjen e procesit gjyqësor nga Autoriteti është më e lartë se 50%.
5. Kriteret bazë për vlerësimin e mundësisë për humbjen e çështjes gjyqësore me qëllim krijimin e provigjonit do të konsiderohen:
 - a) Shkalla e gjykimit të çështjes,
 - b) Kohëzgjatja e procesit gjyqësor,
 - c) Nëse autoriteti është palë e tretë,
 - d) Nëse objekti është i matshëm, etj.

Neni 30

Llogaritja e vlerës së provigjonit

1. Në rastin kur mundësia/probabiliteti për humbjen e procesit gjyqësor nga Autoriteti vlerësohet nën/mbi 50% (e ulët/e lartë), llogarit vlerën e provigjonit, sipas përcaktimeve në nenin 29, me formulën:

$$\text{Provigjoni} = \Sigma (\text{Shuma e kërkesë padisë} \times \text{Probabiliteti i vlerësuar})$$

2. Për çështjet gjyqësore, për të cilat është marrë një vendim në shkallë të parë, krijimi i provigjoneve do të llogaritet si më poshtë:

$$\text{Provigjoni} = \text{Shuma e detyrimit sipas vendimit gjyqësor të shkallës së parë.}$$

Neni 31

Rishikimi Periodik dhe Raportimi në Pasqyrat Financiare

1. Vlera e provigjoneve rishikohet nga strukturat përgjegjëse, brenda muajit janar të çdo viti duke reflektuar ndryshimet apo zhvillimet e proceseve gjyqësore gjatë vitit financiar.
2. Provigjoni regjistrohesh në pasqyrat financiare të Autoritetit, si shpenzim në pasqyrën e shpenzimeve dhe si detyrim në pasiv të llogarisë ushtrimore.

Neni 28, numërohet neni 32.